

Pak pas ndarjes së Titos me Stalinin, më 1948, dhe fillimin e të viteve 50, pyetja që ka dalë në sheh ka qenë sa ka nevojë Jugosllavia e Titos për ndihmë të huaj. Analistët e ekonomisë amerikane kanë thënë shumën e miliarda dollarëve amerikanë si përgjigje, dhe atëherë njëri nga zyrtarët administrativë më të lartë amerikanë ka thënë se është shumë e rëndësishme vetëm që të mbajmë Titon në qarkullim. Nga fundi i viteve tetëdhjetë, kur Ante Markoviq është munduar që ta bëjë të suksesshëm programin e tij ekonomik, vetëm disa nga politikanët perëndimorë e kanë kup-tuar rëndësinë e implementimit të këtij programi. Qytetarët e Jugosllavisë kanë pasur nevojë të madhe për një simbol identifikimi pas dështimit të ekonomisë vetëme-naxhuese socialiste dhe dështimit të lëvizjes joradhitëse. Ky do të jetë dinari konvertibil i Markoviqit. Siç ka theksuar A. Ross Johnson, komuniteti ndërkombëtar - përfshirë edhe SHBA-në dhe ish-BRSS-në - janë munduar që të mbajnë status quo-në dhe të mbajnë Jugosllavinë, e cila është shndërruar në një arkivol të zbrazët. Në vend që të kërkojnë një mënyrë për transferim paqësor, komuniteti ndërkombëtar është munduar të përjetësojë regjimin e mëparshëm dhe është munduar të ruajë Jugosllavinë, duke bërë kështu shumë pak për ta ndalur dhunën. Duke iu referuar shumicës së autorëve perëndimorë, të huajt, në fund të tetëdhjetave dëshironin me çdo kusht të ruanin integritetin e territorit të Jugosllavisë. Shumë autorë e fajësojnë Perëndimin për moszgjidhjen e problemit, por edhe për shpërbërjen shumë të dhunshme të ish-Jugosllavisë. Gjithashtu, Slobodan Milosheviq e ka filluar mbrojtjen e tij në Hagë, duke i fajësuar të huajt për ndarjen e Jugosllavisë.

“Komuniteti ndërkombëtar ka qenë forca kryesore e shkatërrimit

“Komuniteti ndërkombëtar dhe ish-Republika e Jugosllavisë” (1) Jugosllavia e Titos dhe ndihma nga jashtë

Në vend që të kërkojnë një mënyrë për transferim paqësor, komuniteti ndërkombëtar është munduar të përjetësojë regjimin e mëparshëm dhe është munduar të ruajë Jugosllavinë, duke bërë kështu shumë pak për ta ndalur dhunën

të Jugosllavisë, duke e akuzuar Gjermaninë, Austrinë, SHBA-në dhe Vatikanin... Është një fakt themelor historik se duhet të veprohet që nga fillimi kur dëshiron të kuptosh se çfarë e ka udhëhequr Jugosllavinë në të gjitha që kanë ngjarë, që nga 1991 e deri më sot, dhe ky është shkatërrimi i dhunshëm i një shteti evropian, i cili e ka origjinën nga shteti i Serbisë, aleati i vetëm i botës demokratike gjatë dy shekujve të kaluar nga kjo pjesë e botës”, ka thënë ai.

Ekipi që e përpilon këtë raport nuk beson në këtë. Ka qenë e mundur që procesi i shkatërrimit do të mund të ishte më paqësor nëse të fuqishmit do të vepronin ndryshe. Ekipi pajtohet se SHBA-ja ka rol vendimtar në procesin e shkatërrimit të Jugosllavisë. Kanë qenë tri faza të politikës amerikane në luftërat evropiane në përgjithësi: (1) SHBA-ja nuk ka dashur të ndërhyjë në problemet evropiane - më shumë se sa që kanë bërë gjatë luftërave të Evropës në gjysmën e parë të shekullit XX. Më vonë kanë filluar të ndërhyjnë me gjithë mundësitë e tyre si superfuqi për të ndalur luftimet. (2) Së pari, kjo ndërhyrje është bërë me diplomaci, dhe në fund (3) me anë të intervenimeve ushtarake. Politika e SHBA-së ndaj Jugosllavisë gjithashtu ishte përcaktuar nga opinionet e sondazheve të brendshme. SHBA-ja, që nga 1948-a e ka përkrahur Jugosllavinë e bashkuar dhe demokratike që nga vdekja e Titos.

Anëtari i ekipit tonë, Ross Johnson e ka përcaktuar para vitit 1991

politikën e SHBA-së si përkrahëse e Jugosllavisë së bashkuar dhe të pavarur (josovjetike), gjatë luftës së ftohtë. Kjo është bërë e qartë gjatë kohës së vizitës së presidentit Nixon në shtator të vitit 1970 dhe në shumë rrethana të tjera. Radio Evropa e Lirë asnjëherë nuk është transmetuar në Jugosllavi (deri më 1994). Johnson e ka përshtkruar politikën e SHBA-së ndaj Jugosllavisë më 1980 si njëra nga “shpërfilljet e rrezikshme” dhe ka shkruar: “Qëndrimi i politikës së SHBA-së, i përqendruar kryesisht në zhvillimet jugosllave dhe të Beogradit, por nuk ka qenë i sinqertë ose qëllimisht “pro serb”. Ai e ka përfunduar një studim mbi RAND politikën për State Departmentin në fillim të viteve tetëdhjetë, duke nxjerrë diskutime të shumta mes zyrtarëve të SHBA-së dhe aatyre jugosllavë në shumicën e republikave, të cilat kanë bërë përpjekje (pa ndonjë sukses), që të kundërshtojnë këtë përqendrim jo proserb që vinte nga ndikimi amerikan. Kjo mospërputhje e politikës së SHBA-së gjatë kësaj periudhe është evidente edhe nga letra e ambasadorit Warren Zimmerman, e adresuar tek Konferenca e Institutit Ndërkombëtar të Studimeve Strategjike në Zurich, në shtator të vitit 1991, ku ai ka kërkuar përkrahje për qeverinë e Ante Markoviqit, ka kritikuar ministrin e Jashtëm të Gjermanisë, Hans Dietrich Genscher, për trajtimin e problemit të Jugosllavisë dhe ka thënë se Jugosllavia është një problem evropian dhe jo amerikan. Agjencia intelektjente qendrore,

CIA, ka dalë në tetor të 1990 me parashikimin se Jugosllavia do të mund të ndërpresë funksionin e saj brenda një viti ose do të shpartallohet brenda dy vjetëve. CIA e ka vërejtur rrezikun e kalimit nga dhuna etnike në luftë civile ndërmjet republikave, por e ka konsideruar atë si të papëlqyer. Nga këndvështrimi i historianëve, ky raport është relativisht një analizë e mirë e situatës në Jugosllavi, mirëpo në gjykimin kyç analistët e CIA-së kanë shkruar se as Partia Komuniste, por as Ushtria jugosllave nuk do të mund ta mbajnë vendin të bashkuar. Ambasadori i SHBA-së në Beograd, Warren Zimmermann, ka shkruar në kujtimet e tij se analizat parashikuese kanë gabuar vetëm në Kosovë që ka mbetur e tensionuar por e qetë dhe në orar për luftë civile që është shtrirë shumë më shpejt se që është parashikuar. Ai ka besuar se bren-ga që dështimi mund të ketë çmim të lartë i ka shtyrë amerikanët të vazhdojnë përpjekjet për të gjetur një formulë për bashkim. “Shpërbërja nuk është e pashmangshme”, thoshte ai. Mirëpo, administrata e George Bushit të vjetër ka qenë shumë e zënë duke i zgjidhur krizat në Irak dhe nuk ka dashur të involvohej në rajonet e tjera të krizave. Personalitetet kryesore në këtë periudhë kanë qenë ambasadori i SHBA-së në Beograd, Warren Zimmermann, nënsekretari i shtetit, Lawrence Eaglebur, i cili gjithashtu ka shërbyer si ambasador i SHBA-së në Beograd në fund të viteve 70 dhe Brent

Scowcroft, këshilltar i Sigurimit Kombëtar, i cili ka shërbyer si atashe ushtarak në Beograd në fillim të viteve 60. Këta e përfaqësonin lobin pro serb në administratën e Bushit. Këta pjesëtarë të administratës së Bushit në fillim e kanë përkrahur integritetin territorial të Jugosllavisë dhe reformën politike të Ante Markoviqit, megjithëse jo me shumë efekt. Sekretari i Shtetit i SHBA-së, James Baker, shpesh thoshte: “Ne nuk kemi një qen në këtë luftë” dhe presidenti Bush e pyeste së paku një herë në javë Scowcroftin: “Më trego prapë për çfarë bëhet fjalë”. Politikanët e SHBA-së kanë qenë atëherë aq naivë dhe besonin se reformat ekonomike të Ante Markoviqit, së bashku me ndihmën financiare nga Perëndimi, posaçërisht nga SHBA-ja, mund të ndalin tendencat nacionaliste dhe seperatiste. Pyetja këtu është nëse ata vërtet e kanë besuar këtë, ose ata thjesht nuk kanë pasur çka të bënin tjetër.

SHBA-ja e ka lënë Bashkimin Evropian ta udhëheqë këtë problem. Diplomtatët e saj e kanë përcjellë situatën për së afërmi, duke përfshirë krizat në Kosovë më 1980, të cilat nuk janë dëgjuar në State Departament. Në fund të qershorit 1991, State Departamenti është munduar ta qetësojë situatën dhe kanë apeluar që të respektohen parimet e të drejtave të njeriut dhe ndryshimet demokratike, për të cilat ata kanë thënë se mund ta mbajnë Jugosllavinë të bashkuar.

Studimi “Komuniteti ndërkombëtar dhe ish-Republika e Jugosllavisë” është përpiluar nga një grup punues prej 20 ekspertësh të ndryshëm ndërkombëtarë dhe nga trevat e ish-Jugosllavisë. Udhëheqës të studimit kanë qenë Matjaz Klemençiq dhe Dushan Janjiq.

“Rekuiem për një kampion: historia e Mike Tysonit” (9)

Vizita në qendrën rinore të Indianas

“Duhet ta kuptoni. Frank Bruno nuk do të ishte kampion bote, po të mos kisha qenë në burg. Oliver McCall nuk do të kishte qenë kampion, po të mos kisha qenë unë në burg. Michael Moorier nuk do të kishte qenë kampion. Asnjëri prej tyre nuk do të kishte qenë kampion, po të isha unë aty. Ata, thjesht, nuk i kanë kompetencat e kampionit”, thoshte Tysoni

Porta e madhe e hekurt u mbyll prapa krahëve të tij të gjerë. Përpara rrinte e palëvizshme ndërtesa e hirtë. Anash tij katër policë po e drejtonin drejt derës së drunjtë në ndërtesën gri. Mbi derë ishte mbishkrimi: Qendra Rinore e Indianas. Askush nuk e dinte se përse një burg quhej qendra rinore. Të burgosurit e vjetër shpjegonin se quhej kështu se “vizitorët” aty vinin të rinj kryesisht, për t’u larguar pleq të thinjur e të kër-rusur. Mike Tyson ishte 26-vjeçar, kur e kaloi portën e drunjtë të ndërtesës së hirtë të quajtur Qendra Rinore në qytezën Plainfield në shtetin amerikan të Indianas. I kaloi të gjitha procedurat. U njof-tua me shefin e rojave. E zhveshën lakuriq. Ia lëshuan një tub me ujë të ftohtë. Ia dhanë rrobat e reja me vija dhe e dërguan në dhomën e tij. Një shtrat, një lavaman, një filxhan për ta kryer nevojën. Kaq kishte dhoma. Prapa krahëve të tij gjerë u mbyll

sërish një derë. Një derë me shufra hekuri. Boksieri më i famshëm i botës, kampioni më i ri i kategorisë së rëndë i të gjitha kohëve, tani do t’i kalonte gjashtë vjet të tërë në burg, si fajtor për dhunimin e 18-vjeçares Desiree Washington. “Nuk e kam dhunuar kudrën”, do të thoshte shumë vjet më vonë Mike Tyson. “Mirëpo, tani që e kam vuajtur burgun, do të dëshiroja ta kisha dhunuar. E urrej”. I gjendur në burg, Mike Tyson do të gjendej në mesin e shumë kriminelëve që dëshironin ta kishin nga një copëz kampioni si trofe. Secili dëshironte ta maste veten me Tysonin. Mike Tyson duhej sërish t’i kujtonte mësimet që ia kishte dhënë rruga, në vitet shtatëdhjetë në Brooklyn. Grushtet ishin arma e tij e vetme në ambientin e ri, të vrazhdë. Më 8 maj të vitit 1992 ai merr një vërejtje serioze në burg për sjellje violente ndaj të burgosurve të tjerë dhe për kërcënim të njërit prej rojave. Megjithatë, posa i tregoi dhëmbët

e tij, gjatë viteve të tij të kaluara në birrucë, të burgosurit e tjerë nuk do të guxonin ta shqetësonin më dhe Mike Tyson do të shquhej me sjellje të mira. Mediat amerikane pohojnë se gjatë kohës në burg, Mike Tyson e kishte ndërruar fenë dhe e kishte marrë besimin mysliman. Kohën më të madhe e kishte kaluar duke lexuar Kur’anin dhe libra të filozofisë islame. Kishte hyrë në burg për të qëndruar gjashtë vjet atje. Mirëpo, defas një vendim shtetëror ia kishte mundësuar të largohej nga burgu më herët. Më 25 mars të vitit 1995 Mike Tyson do të lirohej nga burgu. Drejtoria e burgut pohonte se po të mos kishte qenë vendimi shtetëror, Tyson do të lirohej nga burgu në shtator të të njëjtit vit, për shkak të sjelljeve të mira që i kishte treguar gjatë tre vjetëve në qeli. Pas tre vjetësh, Mike Tyson do të dilte nga burgu me një terleme myslimanësh në kokë dhe me falënderime për Allahun. Derisa ishte në burg, gazeta “New



Mike Tyson, duke dalë nga burgu më 25 mars të vitit 1995

York Post” kishte shkruar se Mike Tyson e kishte ndërruar fenë dhe e kishte ndërruar emrin. Sipas gazetës, ai kishte marrë emrin Malik Abdul Aziz (Shërbëtori i të Madhërishmit). Mirëpo, ky pohim u quajt i pasaktë nga avokatët e boksierit. Megjithatë, më 25 mars 1995, si njeri i lirë, boksieri do të dilte nga burgu me emrin Mike Tyson, por me falënderime për Allahun. “Unë jam mysliman”, do të deklarojë ai. Megjithatë, bota nuk brengosej shumë për religjionin e Tysonit. Ata dëshironin ta shihnin sërish në ring. Mike Tyson, po ashtu, kishte qejf ta shihte veten sërish në ring. “Allahu, atij i qofshim falë, e di se

unë jam i gatshëm të rrah cilindo njeri, cilëndo kafshë, bile edhe Jezui po të më dalë në mejdan, do të rrahesha me të”, thoshte ai. Ndërkohë, në botën e boksit kishte pasur ndryshime të mëdha në tre vjetët e fundit. Mike Tyson po e shikonte me përbuzje skenën e boksit botëror dhe po bëhej gati të kthehej në të si kampion i padiskutueshëm. “Duhet ta kuptoni. Frank Bruno nuk do të ishte kampion bote, po të mos kisha qenë në burg. Oliver McCall nuk do të kishte qenë kampion, po të mos kisha qenë unë në burg. Michael Moorier nuk do të kishte qenë kampion. Asnjëri prej tyre nuk do të kishte qenë kampion, po të isha unë aty. Ata, thjesht, nuk i kanë kompetencat e kampionit”, thoshte Tyson. Gjatë qëndrimit të tij në burg ai kishte pasur mundësi të çonte pesha dhe të stërviste ngapak. Trupin e kishte mbushur me tatuazhe. Menaxherët, në anën tjetër, po përpiqeshin t’ia gjenini kundërshtarët. Bota gojëhapur po priste me padurim. Pa i marrë parasysh tatuazhet dhe disa kilogramë muskuj më shumë, ata prisnin në ring Mike Tysonin e vjetër. Jo Mike Tysonin të vjetër.

(Në numrin e ardhshëm: Cilat do të jenë meçet e ardhshme të Mike Tysonit? Kur do t’i dalë në mejdan Evander Holyfieldi?)